



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 362/3 Prot.

Tiranë, më 17.06.2025

V E N D I M

Nr. 145, Datë 17.06. 2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi², është regjistruar ankesa me nr. 45, datë 24.02.2025, e paraqitur nga znj. E.M kundër Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, Bashkia Korçë, në të cilën pretendon diskriminim të fëmijëve së saj të mitur K.M dhe K.M , për shkak të “gjendjes ekonomike” dhe “racës”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, znj. E.M , në mes të tjerash informon se: *“Quhem E.M . Jam nënë e 3 fëmijëve. Dy fëmijët e mi janë nxënës të shkollës 9-vjeçare “Naum Veqilhaxhi”, kurse djali i vogël është në moshën 3 vjeçare dhe vuan me spektrin e autizmit. Jam familje që i përkas komunitetit egjiptian.*

Në muajin tetor 2024 lajmërohem nga mësuesja kujdestare për të përgatitur dokumentat për bursë për të dy fëmijët e mi. Këtë bursë e kam përfituar çdo vit pasi jam familje me të ardhura të pakta dhe jam punëkërkuese e papunë. Si çdo vit, përgatis dokumentacionin dhe e dorëzoj pranë shkollës. Mësuesja kujdestare e fëmijëve më thotë që çdo gjë është në rregull.

Në muajin dhjetor dalin emrat e fëmijëve përfitues por emrat e fëmijëve të mi nuk ishin në listë. Pyes mësuesen kujdestare dhe më thotë që je skualifikuar nga Bashkia për shkak se nuk ke dorëzuar vërtetimin si punëkërkuës i papunë. Unë këtë vërtetim nuk mund ta marr dot sepse jam nënë me 3 fëmijë dhe dal në sistem e siguruar. Nga biseda që bëj me mësuesen e fëmijëve më thuhet që vlerësimin e dokumentave nuk e bëjmë ne por bashkia.”.

Ankuesja ka kërkuar nga Komisioneri, shqyrtimin e ankesës dhe përfitimin e bursës për fëmijët e saj.

¹ Në vijim do të referohet LMD.

² Në vijim do të referohet Komisioneri.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me shkresën nr. 362/1 prot, datë 06.03.2025³, Komisioneri, ka njoftuar dhe ka kërkuar parashtrim nga Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, të Bashkisë Korçë, si dhe nga Bashkia Korçë, lidhur me pretendimet e palës ankuese.

1.1 Me shkresën nr. 211 prot, datë 12.03.2025, Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, të Bashkisë Korçë ka kthyer përgjigje në lidhje me ankesën, duke parashtruar:

Për përcaktimin e kuotave financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit në arsimin parauniversitar në Institucionet Arsimore Publike, vlerësimi bëhet duke u bazuar në:

Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit në arsimin parauniversitar në Institucionet Arsimore Publike”;

Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.511, datë 27.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit në arsimin parauniversitar në Institucionet Arsimore Publike”

Sipas këtyre dy vendimeve të Këshillit të Ministrave, znj. E.M , ka kërkuar bursë për fëmijët e saj K.M dhe K.M , nxënës në shkollën “Naum Veqilharxhi”. Sipas dokumentacionit nga Drejtoria e Shkollës, prindi ka dorëzuar dokumentat për të aplikuar për bursë pranë kësaj drejtorie, nga shkolla janë pranuar dokumentat dhe janë dorëzuar pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes. Nga ana jonë dokumentacioni është pranuar dhe është shqyrtuar së bashku me të gjitha dokumentat e tjera të të gjithë nxënësve që kanë aplikuar për bursë.

Të dy nxënësit nuk ka qenë përfitues të bursës për vitin shkollor 2024-2025 pasi dokumentat që ka dorëzuar prindi për aplikim kanë qenë të paplota. Në bazë të dokumentave të dorëzuara, nxënësit

³ Administruar pranë Komisionerit me nr.362/2 prot., datë 17.03.2025.

klasifikohen në kriterin 2.1/c të VKM nr.666, datë 10.10.2019 dhe dokumentacioni që kërkohet për të aplikuar për bursë sipas këtij kriteri është:

- Certifikatë personale.
- Certifikatë familjare.
- Vërtetim nga shkolla (për regjistrim, frekuentim të rregullt dhe jo mbetës).
- Vërtetim të ardhurash/pagë për çdo anëtar madhor të familjes;
- Vërtetim regjistrimi si punëkërkuës i papunë për çdo anëtar madhor të familjes.
- Vërtetim pagese pension pleqërie.
- Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo person madhor të familjes.

Për këtë rast, pranë shkollës nuk janë dorëzuar vërtetimet nga zyra e punës për të dy prindërit.

Mungesa e këtij dokumentacioni ka qenë dhe shkaku pse nxënësit nuk kanë qenë përfitues të bursës për vitin shkollor 2024-2025. Për të qenë përfitues të bursës duhet të ishin dorëzuar të gjitha dokumentat që kërkohen sipas kriterit në të cilin klasifikohen, si dhe duke respektuar afatet kohore për dorëzimin e këtij dokumentacioni.

Për vitin shkollor 2024-2025, skualifikimet nga bursat kanë qenë për mungesë dokumentacioni/dokumentacion i pasaktë ose i korrigjuar dhe dokumentacion i dorëzuar jashtë afatit.

Për vitet shkollore 2022-2023 dhe 2023-2024 nxënësit kanë qenë përfitues të bursës pasi në dokumentat e dorëzuara ka pasur fletë-rekomandimi nga mjeku specialist për të dy nxënësit.

Për sa i përket faktit se si marrin dijeni personat e interesuar në lidhje me dokumentacionin që duhet të dorëzojnë, lista e dokumentave sipas kriterëve të përcaktuara në VKM-në 666, datë 10.10.2019, e ndryshuar, përveç se ju është dërguar drejtorive të shkollave nëpërmjet *e-mailit* është publikuar dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Korçë. Kjo listë është përpiluar bazuar në kriteret për përfitimin e bursës sipas VKM-së përkatëse me qëllim evidentimin sa më të saktë të kriterit në të cilin duhet klasifikuar një aplikues.

Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar nga aplikuesit, përgjegjësia për këtë pjesë është e shkollës, pasi është kjo e fundit që merret me mbledhjen e dokumentacionit dhe pastaj e dorëzon pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes.

Shqyrtimi i aplikimeve për vitin shkollor 2024-2025 është bërë me grup pune me përbërje nga sektorët ekonomik dhe juridik të Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes. Para se grupi i punës të shqyrtonte të gjithë dokumentacionin nga sektori ekonomik i Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, është rishikuar dokumentacioni i sjellë nga shkollat dhe është kthyer për plotësim në rastet kur ka konstatuar mangësi, gjithmonë duke patur parasysh afatin kohor 30.10.2024, si datë e fundit për pranimin e aplikimeve, pasi sipas shkresës së

Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në datë 31.10.2024 duhet dërguar numri i planifikimit të bursave për vitin korrent.

1.2 Bashkia Korçë nuk ktheu përgjigje në lidhje me kërkesën për informacion të Komisionerit bërë sipas shkresës nr. 362/1 prot, datë 06.03.2025.

3. Në mbështetje të neneve 78-86 të Kodit të Procedurave Administrative, nenit 32, pika 1, shkronja c), dhe pikat 2, 3 e 4 të këtij neni, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nenit 39, të Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi⁴”, si dhe në zbatim të Urdhrit nr. 29, datë 05.03.2025, të Komisionerit, në datën 13.03.2025, nga inspektorët e Komisionerit, u realizua inspektimi në ambientet e Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pranë Bashkisë Korçë.

Objekti i inspektimit ishte marrja e informacionit të nevojshëm dhe dokumentacionit respektiv, në kuadër të shqyrtimit administrativ të kësaj çështjeje.

Gjatë takimit me përfaqësueset⁵ e Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pranë Bashkisë Korçë, u mbajt procesverbali përkatës, në të cilin u evidentua se:

- Dokumentacioni i kërkuar për përfitimin e bursës, sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar, nuk bazohet në asnjë akt shkresor të hartuar apo dalë nga ana e NSHMAÇ/Bashkia Korçë apo Bashkia Korçë, por është vendosur sipas interpretimit që Ndërmarrja, i ka bërë kritereve të kësaj VKM-je.
- Nuk ka një procedurë konkrete të përcaktuar lidhur me shqyrtimin e trajtimin e dosjeve të aplikantëve për përfitimin e bursës, por nga praktika e krijuar prej tyre, kur gjatë shqyrtimit të dosjeve kanë konstatuar mungesë ose pasaktësi dokumentacioni, kanë kontaktuar verbalisht me drejtoritë e shkollave dhe u janë dhënë udhëzimet rast pas rasti, sipas specifikës të secilës dosje. Drejtoritë më pas kanë lajmëruar prindërit për plotësimin e dokumentacionit dhe u është lënë një afat i arsyeshëm për plotësimin e dorëzimin e tyre.
- Përgjegjësia për plotësimin e dorëzimin e dokumentacionit është e vetë prindit aplikant dhe nuk është përgjegjësi e Ndërmarrjes për ta siguruar, pavarësisht faktit nëse dokumentacioni disponohet nga institucionet vartëse të Bashkisë.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.

⁴ <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/05/RREGULLORE-KMD.pdf>

⁵ Znj. S. Z, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit Ekonomik, znj. K. Z, me detyrë Specialiste në Sektorin e Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore dhe znj. T. H, me detyrë Psikologe pranë NSHMAÇ.

Pala ankuese pretendon se, është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme, në shkelje të VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave *“Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”*, të ndryshuar, duke mos u trajtuar rasti i fëmijëve së saj, si pjesë e kategorisë përfituese të bursës për vitin shkollor 2024-2025, me arsyetimin e mungesës së dokumentacionit dhe konkretisht të *“Vërtetim regjistrimi si punëkërkuar i papunë për çdo anëtar madhor të familjes”*, në rastin e familjes së ankuses, vërtetimet si punëkërkuar të papunë në emër të ankuses dhe bashkëshortit të saj (verëtimet për të dy prindërit e nxënësve). Kërkimi i ankuses para Komisionerit lidhet me konstatimin e diskriminimit për shkak të *gjendjes ekonomike dhe racës* dhe përfitimin e bursës për dy fëmijët e saj, nxënësit K.M dhe K.M .

Në kontekst të legjitimitetit të ankuses kundrejt subjektit ndaj të cilit ka pretenduar diskriminimin, Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes Korçë/Bashkia Korçë, Komisioneri vëren se, bazuar në kompetencat e sanksionuara nga ligji nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Bashkia Korçë gëzon legjitimitet pasiv në këtë proces, pasi ka tagrin (si entitet) për miratimin dhe dhënien e bursave.

Nga ana tjetër, Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes Korçë/Bashkia Korçë, nuk gëzon legjitimitet pasiv për pretendimin e ankuses për diskriminim, lidhur me mospërfitimin e bursës për dy fëmijët e saj, pasi nuk ka tagrin e miratimit të dhënies së bursës.

Bazuar në rolin tejet të veçantë dhe specifik që ka Ndërmarrja, si një hallkë shumë e rëndësishme lidhur me zhvillimin e gjithë procedurës për përzgjedhjen e kandidatëve përfitues të bursës, pavarësisht faktit se nuk është vendimmarrëse, Komisioneri do të shqyrtojë edhe veprimet e Ndërmarrjes dhe ndikimin që ato kanë pasur tek vendimmarrja e Bashkisë lidhur me miratimin/mosmiratimin e bursës. Në mënyrë direkte, e gjithë vendimmarrja e Bashkisë lidhur me miratimin e dhënies së bursave është e bazuar në procedurën e zhvilluar nga NSHMAÇ dhe e kufizuar në listën e aplikantëve përfitues, të përcjellë prej saj.

Në këtë kontekst, Komisioneri, do të marrë në shqyrtim pretendimin e ankuses, lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm të fëmijëve të saj nga ana e Bashkisë Korçë.

Ligji nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, i ndryshuar, në nenin 1, të tij përcakton se: *“Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionimin e njërive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre e të organeve përkatëse”*.

Neni 9, pika 1.1/ç), e Ligjit⁶, përcakton se: *“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: 1.1. Të drejtën dhe përgjegjësinë e vetëqeverisjes, sipas së cilës:*

⁶ Referuar ligjit sipërcituar me nr. 139/2015, i ndryshuar.

...ç) krijojnë njësi ekonomike dhe institucione në varësi të tyre”.

Në nenin 24⁷, i Ligjit, përcakton se, bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve, ndër të tjera dhe: “... *Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit, etj. sipas mënyrës së përcaktuar me ligj*”.

Instrumentet për administrimin e shërbimeve publike, janë përcaktuar në nenin 33, të Ligjit, duke parashikuar se:

“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore sigurojnë dhënien e shërbimeve publike, nëpërmjet një ose më shumë instrumenteve të mëposhtme:

- a) njësi organizative të veta, që janë pjesë e strukturës administrative të njësisë vendore;*
- b) ndërmarrjeve për shërbimet publike, sipas legjislacionit në fuqi;*
- c) kontraktimit të dhënies së shërbimeve me palë të treta;*
- ç) përdorimit të instrumenteve të përshtatshme të partneritetit publik dhe privat, sipas legjislacionit në fuqi;*
- d) krijimit të shoqërive tregtare në pronësi apo bashkëpronësi të njësisë vendore, sipas legjislacionit në fuqi.*

.....

3. Njësia e vetëqeverisjes vendore mund të ofrojë mbështetje financiare për ndërmarrjet bashkiake për shërbimet publike dhe/ose për shoqëritë tregtare me kapital të njësisë së vetëqeverisjes vendore, fusha e veprimtimit të së cilës lidhet me dhënien e një shërbimi publik që është përgjegjësi e kësaj njësie”.

VKM nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “*Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike*”, i ndryshuar, parashikon se:

...4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për uljen e nivelit të braktisjes shkollë, për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimimin, miratojnë bursa financiare me përfitues nxënësit, fëmijët të familjeve në nevojë, pas konfirmimit nga mësuesi kujdestar dhe drejtori i shkollës për frekuentimin e procesit mësimor, si dhe nga zyra vendore e arsimit parauniversitar.

5. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për kategorinë e nxënësve që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimin bazë, dhe për uljen e braktisjes shkollë të arsimit bazë, mund të miratojnë dhe të shpërndajnë bursa edhe nga fondet e veta ose nga fondet buxhetore të përfituara në formën e transfertës së pakushtëzuar.

...

⁷ Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale

8. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në planin e përcaktuar sipas pikës 6, të këtij vendimi, me vendim të këshillit bashkiak, miratojnë dhënien e bursave, sipas kriterëve të përcaktuara në pikat 2.1, 2.2, 2.3 e 2.4, të këtij vendimi.”

VKM nr. 511, datë 27.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar, parashikon se:

“23. Fondet buxhetore për mbulimin e shpenzimeve për bursat, si dhe numri i bursave për nxënësit administrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të shkollave/konvikteve, ku nxënësit studiojnë....”.

Në këtë kuptim, bazuar në sa më sipër, Komisioneri do vijojë trajtimin e ankesës duke analizuar faktin nëse fëmijët e ankueses plotësojnë kushtet për përfitimin e pagesës për nxënësit e arsimit parauniversitar bazë në institucionet arsimore publike, në zbatim të pikës 2.1/c, të VKM-së sipërcituar, si dhe, nëse skualifikimi i tyre për mangësi në dokumentacionin e dorëzuar është i drejtë dhe i bazuar ligjërisht.

Në analizë të legjislacionit, dokumentacionit dhe informacionit të depozituar nga palët, Komisioneri vëren se:

Komisioneri ka marrë në shqyrtim pretendimet e ankueses për trajtimin diskriminues në procedurën e ndjekur për përfitimin e bursës për fëmijët e saj, nxënësit K.M dhe K.M.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin 10021/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Procedura dhe dokumentacioni i përfitimit të bursës rregullohet sipas përcaktimeve të VKM-së VKM nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar

në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar me VKM nr. 511, datë 27.07.2022. Ky akt ndër të tjera parashikon:

“2. Nxënësit, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet arsimore publike, përfitojnë bursë brenda kuotave dhe kriterëve, si më poshtë vijon:

.....

2.1 Kriteri ekonomik:

.....

c) nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë.”.

Referuar VKM nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar, personat që kërkojnë të trajtohen me bursë, duhet të aplikojnë dhe të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar, pranë Institucioneve Arsimore jo më vonë se muaji tetor dhe pranë Këshillit Bashkiak në fund të muajit dhjetor.

Për të përfituar nga kriteri ekonomik 2.1/c, sipas VKM nr.666, datë 10.10.2019, të ndryshuar, nxënësit, duhet të jenë fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë. Thelbësore për të plotësuar këtë kriter është nga njëra anë që nxënësi të jetë i regjistruar dhe të ndjekë arsimin bazë dhe nga ana tjetër duhet të provohet pamundësia financiare e familjes, për të provuar se nxënësi është fëmijë i familjes në nevojë.

VKM nr.666, datë 10.10.2019, i ndryshuar, ka përcaktuar kriteret që duhet të plotësohen për të përfituar bursë, por jo dokumentacionin që duhet të dorëzohet për të provuar përmbushjen e kriterëve.

Gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi se, me shkresën me nr. 1035/1 prot., datë 02.12.2024, të NSHMAÇ, është urdhëruar ngritja e grupit të punës për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumenteve të aplikimeve për bursë. Nuk rezulton që Bashkia të ketë një akt shkresor specifik e konkret, mbi bazën e të cilit të jetë mbështetur e të ketë zbatuar për përcaktimin e dokumentacionit të kërkuar për t’u dorëzuar nga aplikantët për bursë, por ka deklaruar se, është bazuar në interpretimin e kriterëve të VKM-së, si dhe në praktikën e saj të viteve të mëparshme.

Për të qenë përfitues të bursës për vitin shkollor 2024-2025, sipas klasifikimit në kriterin 2.1/c, të VKM nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar, dokumentacioni që kërkohet nga Bashkia Korçë për të përfituar bursë sipas këtij kriteri, është:

- Certifikatë personale.
- Certifikatë familjare.
- Vërtetim nga shkolla (për regjistrim, frekuentim të rregullt dhe jo mbetës).
- Vërtetim të ardhurash/pagë për çdo anëtar madhor të familjes;

- Vërtetim regjistrimi si punëkërkues i papunë për çdo anëtar madhor të familjes.
- Vërtetim pagese pension pleqërie.
- Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo person madhor të familjes.

Gjatë shqyrtimit të ankesës në cilësinë e provës u administruan aktet e mëposhtme:

Akte të depozituara nga Bashkia Korçë

- Vërtetim nr. 1/47 prot, datë 09.10.2024, i Shkollës 9-vjeçare “Naum Veqilharxhi”, Korçë, me anë të të cilit vërtetohet se K.M , është nxënës i klasës së 9-të pranë kësaj shkolle për vitin shkollor 2024-2025.
- Vërtetim nr. 1/46 prot, datë 09.10.2024, i Shkollës 9-vjeçare “Naum Veqilharxhi”, Korçë, me anë të të cilit vërtetohet se K.M , është nxënëse e klasës së 9-të pranë kësaj shkolle për vitin shkollor 2024-2025.
- Certifikatë e gjendjes familjare e datës 04.10.2024.
- Certifikatë personale e fëmijës K.M , e datës 17.10.2024.
- Certifikatë personale e fëmijës K.M , e datës 17.10.2024.
- Vërtetim për Aftësinë e Kufizuar në emër të P.M , lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror (*Gjeneruar nga sistemi PAK*)
- Vërtetim datë 18.10.2024, nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë, në të cilin vërtetohet se E.M (babai), nuk figuron i regjistruar në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Korçë.
- Vërtetim datë 04.10.2024, nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë, në të cilin vërtetohet se E.M (nëna), nuk figuron e regjistruar në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Korçë.
- Vërtetim datë 04.10.2024 nga Drejtoria e Kujdesit Social e Bashkisë Korçë, në të cilin vërtetohet se E.M , nuk trajtohet me ndihmë ekonomike dhe kompensim të energjisë elektrike nga ana e kësaj bashkie.
- Vërtetim datë 11.11.2024 nga Drejtoria e Kujdesit Social e Bashkisë Korçë, në të cilin vërtetohet se P.M , përfiton pagesën e aftësisë së kufizuar në shumën 14564 lekë.

Akte të depozituara nga ankuesja

- Vërtetimet nr.106 prot dhe nr. 107 prot, datë 31.01.2025, lëshuar nga Unioni Egjiptianët e Shqipërisë, në të cilët vërtetohet se K.M dhe K.M , i përkasin pakicës kombëtare egjiptiane.
- Vërtetim për përfitimin e ndihmës ekonomike, vulosur elektronikisht nga Shërbimi Social Shtetëror më datë 13.01.2025, në të cilin vërtetohet se E.M , nuk është përfitues i ndihmës ekonomike si anëtar i familjes/individ në nevojë.
- Vërtetim për përfitimin e ndihmës ekonomike, vulosur elektronikisht nga Shërbimi Social Shtetëror më datë 13.01.2025, në të cilin vërtetohet se E.M , nuk është përfitues i ndihmës ekonomike si anëtar i familjes/individ në nevojë.
- Vërtetim regjistrim si punëkërkues i papunë, datë 29.01.2025, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, DR AKPA Korçë, në të cilin vërtetohet se E.M është regjistruar si punëkërkues i papunë pranë Zyrës Venbdore të Punësimit ZV AKPA Korçë.

- Vërtetim nr. 1/2 prot dhe nr.1/3 prot., datë 13.01.2025, të Shkollës 9-vjeçare “Naum Veqilharxhi”, Korçë, me anë të të cilëve vërtetohet respektivisht se K.M dhe K.M , janë nxënës të klasës së 9-të pranë kësaj shkolle për vitin shkollor 2024-2025.
- Vërtetim datë 10.01.2025, nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë, në të cilin vërtetohet se E.M (babai), nuk figuron i regjistruar në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Korçë.
- Vërtetim datë 10.01.2025, nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë, në të cilin vërtetohet se E.M (nëna), nuk figuron e regjistruar në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Korçë.
- Vërtetim për Aftësinë e Kufizuar në emër të P.M , lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror (*Gjeneruar nga sistemi PAK*)
- Vërtetim për Bazën e Vlerësuar, datë 10.01.2025, lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në të cilin vërtetohet se për periudhën janar 2023 – nëntor 2024, për llogari të E.M , janë derdhur kontribute mujore, nga Shërbimi Social Shtetëror, në kuadër të Programit të Veçantë për Gratë e Papuna.

Rezulton se, arsyeja e mospërfitimit të bursës për rastin e fëmijëve të ankueses është fakti se nuk janë dorëzuar vërtetimet si punëkërkuar të papunë për të dy prindërit e nxënësve, ankueses E.M (nëna) dhe E.M (babi), të cilët sipas certifikatës së gjendjes familjare figurojnë dy personat madhorë të familjes.

Ankuesja pretendoi gjatë shqyrtimit të ankesës se ajo nuk mund ta dorëzonte një vërtetim të tillë, sepse është përfutuese e programit për mbrojtje të veçantë nga shteti për gratë e papuna me tre apo më shumë fëmijë. Nga aktet e administruara rezultoi e provuar se, për periudhën janar 2023-nëntor 2024 janë derdhur kontribute mujore, nga Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH), në kuadër të Programit të Veçantë për Gratë e Papuna.

Sipas VKM Nr. 751, datë 1.12.2022 “*Për një Mbrojtje të Veçantë nga Shteti për Gratë e Papuna me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç*”, përcaktohet se:

“1. Grave të papuna me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku njëri prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç dhe familja ka të ardhura nën 100 000 (njëqind mijë) lekë në muaj, periudha e kujdesit ndaj fëmijës deri në moshën 5-vjeçare njihet si periudhë sigurimi për efekt përfitimi pensioni pleqërie dhe barrë lindjeje.

2. Kontributet e sigurimeve shoqërore për degën e sigurimit të pensioneve dhe degën e sigurimit të barrë lindjes paguhen në nivelin e pagës minimale në shkallë vendi.

3. Shërbimi Social Shtetëror përcakton listën e grave që përfitojnë mbrojtje të veçantë dhe çdo muaj llogarit dhe kryen pagesën e kontributeve, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të udhëzimit të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe çështjet sociale.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij vendimi.”

Në këto kushte, rezulton se ankuesja nuk mund të depozitonte për llogari të saj vërtetimin si punëkërkuese e papunë, sipas dokumentacionit të kërkuar nga Bashkia Korçë për të përfutur sipas kriterit 2.1/c të VKM nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar.

Sipas dokumentacionit të kërkuar, nga Bashkia Korçë për të përfutur sipas kriterit 2.1/c të VKM nr.666, datë 10.10.2019, të ndryshuar, duhet që të ishte depozituar edhe vërtetimi si punëkërkuës i papunë i bashkëshortit z. E.M . Referuar dokumentacionit i cili figuron që të jetë depozituar gjatë aplikimit, rezulton se nuk është depozituar përveç vërtetimit në emër të ankueses, edhe vërtetimi si punëkërkuës i papunë në emër të bashkëshortit të ankueses z.E.M (babai). Vërtetimi i regjistrimit si punëkërkuës i papunë, i datës 29.01.2025, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, DR AKPA Korçë, në të cilin vërtetohet se E.M është regjistruar si punëkërkuës i papunë pranë Zyrës Vendore të Punësimit ZV AKPA Korçë, nuk provon se ky dokument është depozituar gjatë procesit të aplikimit për përfitim të bursës, pasi është lëshuar pasi ka përfunduar i gjithë procesi i aplikimit dhe miratimit të bursave.

Rezulton e provuar se familja e ankueses nuk trajtohet me ndihmë ekonomike. Në kushtet kur VKM nr.666, datë 10.10.2019, e ndryshuar, ka përcaktuar vetëm kriteret që duhet të plotësohen për të përfutur bursë, por jo dokumentacionin që duhet të dorëzohet për të provuar përmbushjen e kriterëve, dhe sa kohë që fëmijët e saj nuk vijnë nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, Komisioneri vlerëson se pala ankuese nuk ka përmbushur detyrimin për të dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ana e Bashkisë Korçë, në kushtet kur skualifikimi ka ardhur si pasojë jo vetëm e mos depozitimit të vërtetimit si punëkërkuese e papunë për ankuesen, por edhe si pasojë e mos depozitimit të vërtetimit në emër të bashkëshortit të saj z. E.M .

Skualifikimi nga përfitimi i bursës për fëmijët e ankueses, vetëm për shkak të mosparaqitjes së vërtetimit si punëkërkuese e papunë në emër të ankueses do të ishte i pabazuar dhe i padrejtë, sa kohë që ajo si përfutuese e Programit të Veçantë për Gratë e Papuna, sipas VKM Nr. 751, datë 1.12.2022, nuk mund të pajiset me vërtetimin si punëkërkuese e papunë, pasi në emër të saj derdhen kontribute të sigurimeve shoqërore nga ana e SHSSH. Në bazë të fakteve dhe rrethanave të cilat rezultuan të provuara gjatë shqyrtimit të ankesës, rezultoi e provuar se fëmijët e ankueses nuk janë skualifikuar për shkak të mosdorëzimit të vërtetimit në emër të ankueses, por sepse gjatë procesit të aplikimit nuk është dorëzuar edhe vërtetimi si punëkërkuës i papunë për bashkëshortin e ankueses, z. E.M .

Në rast se familja e ankueses, do të kishte qenë përfutuese e ndihmës ekonomike, bazuar edhe në praktikën e Komisionerit, kërkesa për të depozituar vërtetimin si punëkërkuës i papunë për të dy prindërit e fëmijëve, do të përbënte një kërkesë të tepërt dhe të panevojshme, pasi ky dokumentacion disponohet nga Bashkia Korçë, duke qenë se dosja e personit që përfiton pagesën e ndihmës ekonomike administrohet prej saj, duke krijuar për aplikantin një barrë të tepërt.

Referuar provave dhe informacionit të administruar gjatë shqyrtimit të ankesës, si dhe kriterëve të përcaktuara në VKM-në sipërcituar, për përfitimin e bursës nga fëmijët e ankueses, K.M dhe K.M , bazuar në kriterin joekonomik, do të duhej që statusin e invalidit, (AK) ta gëzonte njëri nga prindërit e tyre (*ankuesja ose bashkëshorti i saj*), dhe jo një familjar tjetër (*përveç prindit*), siç është në rastin konkret vëllai i tyre P.M .

Rezulton e provuar se fëmijët Kristina dhe K.M , i përkasin pakicës kombëtare egjiptiane, por bazuar në VKM nr.666, datë 10.10.2019, të ndryshuar, pika 2.3“*Kriteri joekonomik*”, germa “dh”, nxënësit e pakicës kombëtare rome dhe egjiptiane, janë përfitues të burës kur ata regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm profesional. Në rastin e fëmijëve të ankueses, nxënësit Kristina dhe K.M janë regjistruar dhe ndjekin klasën e 9-të, të arsimit bazë.

Sa më sipër, mbështetur në ligjin 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, si dhe nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura dhe provave të administruara, Komisioneri vlerëson se fëmijët e ankueses, nxënësit K.M dhe K.M , nuk janë ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, nga ana e Bashkisë Korçë. Në mungesë të trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm, Komisioneri gjykon se nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkaqet e pretenduara nga pala ankuese.

Komisioneri, vlerëson se për sa më sipër, nuk konstatohet se ka shkelje të ligjit 10221/2020 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, nga ana e Bashkisë Korçë, lidhur me trajtimin e rastit të nxënësve K.M dhe K.M .

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 32 dhe 33, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të nxënësve K.M dhe K.M ⁸, për shkak të gjendjes ekonomike dhe racës, nga ana e Bashkisë Korçë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Gjendja ekonomike, raca

Fusha: Arsim

Lloji vendimit: Mosdiskriminim

⁸ Përfaqësuar nga nëna, znj. E.M .